

Vendim nr. 88 datë 26.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 26.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (B) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **BESNIK LAMÇJA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 443, datë 08.05.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.**

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, paragrafët 1 dhe 3, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Besnik Lamçja është hetuar në mungesë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për veprat penale “Vrasja me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, “Vjedhja me dhunë”, të kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje të armëve luftarake”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 25, 78, 139 dhe 278/2 të Kodit Penal (KP), në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes.

2. Me vendimin nr. 443, datë 08.05.2003, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendim të kryer në bashkëpunim, dhe dënimin me 22 vite burgim. Deklarimin fajtor për kryerjen e veprës penale të vjedhjes me armë në bashkëpunim dhe dënimin me 13 vite burgim. Deklarimin fajtor për kryerjen e veprës penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, dhe dënimin me 1 vit burgim. Në zbatim të nenit 55 të KP-së, dënimet e mësipërme bashkohen duke i caktuar atij një dënim përfundimtar të vetëm prej 25 vite burgim.”*. Nga përmbajtja e vendimit gjyqësor rezulton se kërkuesi është gjykuar në mungesë dhe atij i është caktuar mbrojtës kryesisht nga gjykata, pas njoftimit të familjarëve, te cilët nuk kanë zgjedhur mbrojtës nga ana e tyre.

3. Duke qenë se kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është paraqitur ankim, ai ka marrë formë të prerë në datën 18.05.2003.

4. Pas ngjarjes, kërkuesi është shpallur në kërkim dhe arrestimi i tij nuk është bërë i mundur deri në datën 09.09.2022, kur ai është ekstraduar nga shteti italian për llogari të shtetit shqiptar, siç rezulton nga procesverbali për ekzekutimin e vendimit penal të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Aktualisht rezulton se kërkuesi është duke vuajtur dënimin në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale nr. 313, Tiranë.

5. Në datën 17.02.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit nr. 443, datë 08.05.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi** ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

6.1. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi procesi gjyqësor i zhvilluar ndaj tij ka qenë një fasadë. Provat nuk janë vlerësuar realisht dhe fajësia e tij ka qenë e paravendosur.

- 6.2. *Së drejtës së mbrojtjes*, pasi kërkuesit i është mohuar e drejta për të përfituar nga gjykimi i shkurtuar, si dhe e drejta për të kërkuar kryerjen e aktit të ekspertimit.
- 6.3. *Parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve*, pasi gjykatat nuk i kanë dhënë atij dhe mbrojtësit të tij mundësi të njëjta për paraqitjen e provave dhe argumenteve, në krahasim me prokurorin në paraqitjen e akuzës.
- 6.4. *Standardit të arsyetimit*, pasi gjykata në vendimin e saj nuk ka përshkruar mekanizmin e ngjarjes, mungon përmbledhja e rrethanave të faktit dhe arsyetimi se në ç’ mënyrë e ka kryer veprën penale. Viktima është vetëvranë, gjë që hedh poshtë pretendimet e ekspertit dhe aktit të ekspertimit të pranuar nga gjykata. Indictet e prokurorisë nuk janë të shumta në numër, të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën. Gjykata nuk ka kryer hetim të plotë e të gjithanshëm për të çmuar provat, siç parashikohet nga neni 152 i Kodit të Procedurës Penale. Vendimi ka mangësi në arsyetimin e tij në lidhje me cilësimin e kryerjes së veprave penale në bashkëpunim.
- 6.5. *Parimit të paanshmërisë*, pasi gjykata ka dhënë një vendim të padrejtë dhe antikushtetues, pa marrë parasysh moshën e re të kërkuesit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

8. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton

mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Duke analizuar respektimin e këtyre kriterëve në rastin konkret, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin e kundërshtuar dhe është bartës i të drejtave kushtetuese.

10. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, rezulton se kërkuesi është ekstraduar nga shteti italian në datën 09.09.2022, datë në të cilën ka marrë dijeni efektivisht për vendimin penal nr. 443, datë 08.05.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përmes të cilit është deklaruar fajtor, duke nënshkruar edhe procesverbalin përkatës (*shih procesverbalin e datës 09.09.2022 të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë*). Ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 17.02.2023, pra jashtë afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, e ligjit nr. 8577/2000.

11. Për sa më lart, në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës dhe nenit 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor. Në këto kushte, mosplotësimi i kriterit paraprak për afatin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatë e bën të panevojshme analizën e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

12. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa e paraqitur nuk i plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.